



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:220910  
Datë: 29.01.2025  
Numri i dokumentit: 06771151

Rev.nr.474/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Milena Deric dhe Muhamet Rexha, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R. J. nga P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Idriz Ibraj, avokat në Pejë, kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A, me seli në Prishtinë, Distrikti në Pejë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L. S., me objekt të padisë anulim vendimi, kthim në punë dhe kompensimin e pagave, duke vendosur sipas revizionit të paditësit, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4694/21, të datës 18.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.01.2025, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet i pathemeltë revizioni i paditësit R. J. nga P., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4694/21, të datës 18.04.2024.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.555/19, të datës 15.03.2021, në pikën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit R. J. nga P., me të cilën ka kërkuar që të “ANULOHEM vendimi i atakuar nr. 11263, i datës 17.10.2018 i të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS sh.a. Prishtinë-Distrikti në Pejë, me të cilin paditësit i ndërprehet kontrata e punës, si jo e bazuar, DETYROHET e paditura që paditësin ta kthej në vendin e tij të punës teknik për prishje në Divizionin e Rrjetit të KEDS-it Departamenti i Sistemit të Operimit për Distriktin e Pejës, dhe të detyrohet e paditura që paditësit në emër të pagave të papaguara t’ia kompensoj shumën prej 15,795.00 €, në emër të tatimit në pagë shumën prej 977.87 € dhe në emër të kontributit pensional shumën prej 1,631.00 €, me kamatë 8% duke e llogaritur nga data 30.05.2018 e deri

në pagesën definitive si dhe shpenzimet procedurale. Në pikën II të dispozitivit ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës”.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, me aktgjykimin Ac.nr.4694/21, të datës 18.04.2024, e ka refuzuar të pabazuar ankesën e paditësit R. J., ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.555/19, të datës 15.03.2021, e ka vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të pranojë në tërësi si të bazuar revizionin e paditësit, të prishë aktgjykimet e instancave më të ulëta dhe lëndën ta kthejë në rigjykim.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i paditësit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi R. J., përmes të autorizuarit të tij të tij me datë 22.11.2018, ka paraqitur padi në Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të anulohen si të kundërligjshëm vendimi i atakuar nr. 11263, i datës 17.10.2018 i të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS sh.a. Prishtinë-Distrikti në Pejë, me të cilin paditësit i ndërprehet kontrata e punës, si jo e bazuar, të detyrohet e paditura që paditësin ta kthejë në vendin e tij të punës teknik për prishje në Divizionin e Rrjetit të KEDS-it Departamenti i Sistemit të Operimit për Distriktin e Pejës, dhe të detyrohet e paditura që paditësit në emër të pagave të papaguara t’ia kompensojë shumën prej 15,795.00 €, në emër të tatimit në pagë shumën prej 977.87 € dhe në emër të kontributit pensional shumën prej 1,631.00 €, me kamatë 8% duke e llogaritur nga data 30.05.2018 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.555/19, të datës 15.03.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka theksuar se në bazë të provave të administruara gjykata ka gjetur së kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, ngase është vërtetuar se e paditura i ka respektuar në tërësi dispozitat ligjore në fuqi me rastin e ndërprerjes të marrëdhënies së punës paditësit. Fillimisht me vendimin nr.5671, të datës 30.05.2018, e paditura e suspendon paditësin nga marrëdhënia e punës, duke e larguar përkohësisht nga puna, duke ia njohur të drejtën e kompensimit të pagës në 50%, sipas nenit 74 të Ligjit të Punës dhe nenit 9 par 9.2 pika (a) të Kodit Disiplinor. Tutje e paditura ka mbajtur seancë dëgjimore, ku ka konstatuar se paditësi me sjelljet e tij kishte vepruar në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 nën paragrafi (h) dhe (l) të Kodit Disiplinor, për shkak se i njejtë në bashkëpunim me kolegët e tij I. H. dhe F. K. kanë keqpërdorur detyrat e punës me qëllim që vetes ti sjellin përfitim material në mënyrë të kundërligjshme. Kjo ngase F. K. dhe I. H., pas

demontimit të stabilimentit elektrik (ormani i ndërprerësit TU 630 kVA) dhe pas konsultimit paraprak me ish udhëheqësin e ekipit të prishjeve këtu paditësin R. J., i cili iu kishte thënë që pjesët (zbarrat) të cilat mund të përdoren ti ruani ndërsa pjesët që nuk mund të përdoren ti marrin, të njëjtit i kanë marrë dhe i kanë shitur në vlerë prej 82 deri 84 €, ndërsa nga kjo shumë 20 euro i kishte pranuar paditësi R. J.. E paditura me vendimin kontestues i ka ndërpre paditësit marrëdhënien e punës për shkak se veprimet e tij konform nenit 7 par 1 nën par (h) dhe (l) sipas Kodit Disiplinor kualifikohen si shkelje të rënda e detyrave të punës. Nga gjendja faktike e vërtetuar gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar në pajtim me dispozitat e lartcekura dhe në përputhje me dispozitën e nenit 85 të Ligjit të Punës kur ka vendosur që paditësit t'i shqiptoj masën disiplinore ndërprerja e marrëdhënies së punës. Kjo për faktin se me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës paditësit, e paditura ka zbatuar në tërësi procedurën disiplinore të paraparë me Kodin Disiplinor dhe Kodit të Punës të saj, si dhe ka zbatuar në tërësi dispozitat e Ligjit të Punës, për këtë arsye gjykata vlerëson se edhe kërkesa e paditësit për kthim në vendin e punës dhe kërkesa për kompensim të dëmit material për shkak të mos realizimit të pagave, është e pabazuar, andaj duke u bazuar në të lartcekurat, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit në procedurën ankimore ka vlerësuar se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë, si dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, për çka edhe e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e palës paditëse, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimin të atakuar me revizion ndër të tjera ka theksuar se Gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë, si në dispozitivin e aktgjykimin të atakuar me ankesë, pasi siç shihet nga shkresat e lëndës, paditësi ka kryer shkelje disiplinore si rezultat i së cilës edhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dispozitivi i aktgjykimin të ankimuar është mjaft i kjohtë, i kuptueshëm dhe i përmbarueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimin duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për pathemelësinë e kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet e çështjes, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata në fjalë i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës, vendimi për ndërprerjen e kontratës, ligjshmëria e këtij vendimi, e deri te lartësia dhe shkalla e përgjegjësisë së të paditurës për rastin në fjalë. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë në raport me ligjshmërinë e veprimeve të të paditurës karrshi paditësit, për rastin në fjalë, i pranon si të tilla edhe Gjykata e Apelit, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm. Pretendimi i paditësit se gjykata ka bërë shkelje të procedurës kontestimore, nga shkak se ka dështuar ti sigurojë dëshmitarët e propozuar dhe të aprovuar nga gjykata lidhur me rastin në fjalë, një pretendim i tillë nuk qëndron sepse i autorizuari i paditësit, ka kërkuar nga gjykata e shkallës së parë që të revokohet aktvendimi për dëgjimin e dëshmitarëve, andaj edhe gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar propozimin dhe e ka revokuar aktvendimin për dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar. Ndërsa pretendimi tjetër ankimor se gjykata e ka refuzuar propozimin për dëgjimin e

auditorëve në cilësi të dëshmitarëve, një pretendim i tillë është i pa bazuar, sepse pala paditëse nuk ka bërë një propozim të tillë gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore. Po ashtu gjykata ankimore ka vlerësuar pretendimet për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe ka ardhur në përfundim se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor dhe arsyet të cilat i ka dhënë gjykata e shkallës së parë kjo gjykatë e pa të pa arsyeshme që ti përsërisë edhe njëherë. Është vërtetuar në plotëni se paditësi ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës, keqpërdorim i pozitës apo tejkallim i autorizimeve dhe për veprimet e pakujdesshme në kryerjen e detyrave që i shkaktojnë dëme pronës apo financave të KEDS-it, nga neni 7 paragrafi 7.1 nën paragrafi (h) dhe (l) të Kodit Disiplinor të KEDS. Paditësi vetë i ka pranuar pretendimet e të paditurës me rastin e zhvillimit të procedurës disiplinore për shkeljet e pretenduara të të paditurës dhe i njëjti është penduar për veprimet e veta dhe i njëjti e ka nënshkruar procesverbalin e datës 15.05.2018.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Përkundër faktit se pala paditëse, përkatësisht i autorizuari i tij në revizion e paraqitur është thirrur në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, mirëpo shprehimisht nuk ka përmendur asnjë shkelje dhe nuk ka dhënë asnjë arsye, rreth shkeljeve të pretenduara të dispozitave të LPK-së. Si rezultat i kësaj, kjo gjykatë ka trajtuar aktgjykimin e shkallës së dytë vetëm në aspektin e ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Si rrjedhojë, sipas Gjykatës Supreme aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje esenciale nga neni 215 të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, ndërsa për shkelje të tjera siç është konstatuar edhe më lartë nuk ka pasur pretendime në revizion.

Gjykata Supreme e Kosovës e ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Në lidhje me këtë është i drejtë dhe i ligjshëm qëndrimi juridik i gjykatave të instancave më të ulëta se e paditura nuk ka bërë shkelje ligjore me rastin e marrjes së vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit. Kjo për faktin se vendimi i të paditurës nr.11263, i datës 17.10.2018, me të cilin paditësit i është shqiptuar masa disiplinore – ndërprerje e marrëdhënies së punës, ka rezultuar të jetë marrë pas zhvillimit të ligjshëm të procedurës disiplinore dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ku paditësi është shpallur përgjegjës për shkak të shkeljes së rëndë të detyrave të punës, keqpërdorim i pozitës apo tejkallim i autorizimeve dhe për veprimet e pakujdesshme në kryerjen e detyrave që i shkaktojnë dëme pronës apo financave të KEDS-it, nga neni 7 paragrafi 7.1 nën paragrafi (h) dhe (l) të Kodit Disiplinor të KEDS. Në lidhje me këtë, referuar shkresave të lëndës rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta mbi bazën e vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike edhe e kanë zbatuar drejtë të drejtën materiale. Si rezultat i kësaj, është provuar fakti se fillimisht me vendimin nr.5671, të datës 30.05.2018, e paditura e suspendon

paditësin nga marrëdhënia e punës, duke e larguar përkohësisht nga puna, duke ia njohur të drejtën e kompensimit të pagës në 50%, sipas nenit 74 të Ligjit të Punës dhe nenit 9 par 9.2 pika (a) të Kodit Disiplinor. Tutje e paditura në zbatim të procedurës disiplinore ka mbajtur seancë dëgjimore, ku ka konstatuar se paditësi me sjelljet e tij kishte vepruar në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 nen paragrafi (h) dhe (l) të Kodit Disiplinor, për shkak se i njëjti në bashkëpunim me kolegët e tij I. H. dhe F. K. kanë keqpërdorur detyrat e punës me qëllim që vetes ti sjellin përfitim material në mënyrë të kundërligjshme. Kjo ngase F. K. dhe I. H. pas demontimit të stabilimentit elektrik (ormani i ndërprerësit TU 630 kVA) dhe pas konsultimit paraprak me ish udhëheqësin e ekipit të prishjeve këtu paditësin R. J., i cili iu kishte thënë që pjesët (zbarrat) të cilat mund të përdoren ti ruani, ndërsa pjesët që nuk mund të përdoren ti marrin, të njëjtit i kanë marrë dhe i kanë shitur në vlerë prej 82 deri 84 €, ndërsa nga kjo shumë 20 euro i kishte pranuar paditësi R. J.. Këtë fakt rezultoi ta ketë pranuar edhe paditësi gjatë deklarimit të tij para auditorit të brendshëm me datë 15.05.2018, por edhe në procedurën disiplinore të mbajtur nga e paditura.

Si rrjedhojë, edhe me të drejtë është vlerësuar nga gjykatat e instancës më të ulët se veprimet e paditësit kualifikohen si shkelje të rënda të detyrave të punës që tërheqin përgjegjësi disiplinore, për të cilën përgjegjësi disiplinore edhe është shqiptuar masa adekuate disiplinore nga e paditura, në përputhje me dispozitën e nenit 85 të Ligjit të Punës.

Në lidhje me pretendimin e paraqitur në revizion nga pala paditëse me të cilin e ka kontestuar çështjen e mos dëgjimit të dëshmitarëve të propozuar I. H. dhe F. K., kjo gjykatë e vlerëson të pabazuar, pasi që referuar procesverbalit të shqyrtimit kryesor, të datës 24.02.2021, rezultoi se i autorizuar i paditësit e ka tërhequr propozimin për dëgjimin e këtyre dëshmitarëve.

Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet tjera sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË  
Rev.nr.474/2024, datë 27.01.2025

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari

Lumni Sallauka